| | |
|---|---|
| EMRI DHE ADRESA | ALBPETROL SHA |
| | PATOS |

| | | |
|---|---|---|
| STATUSI JURIDIK | SH A | |
| DATA E REGJISTRIMIT | 08.04.1999 | Nr. 21158 |
| NIPT | J 82916500 U | |

# PASQYRAT FINANCIARE

TE VITIT USHTRIMOR 2010

(Periudha 01 Janar 2010 deri me 31 Dhjetor 2010)

## RAPORTI I AUDITUESEVE TE PAVARUR

**Drejtuar:**
**Ministrise se Ekonomise,Tregtise dhe Energjitikes;**
**Keshillit Mbikeqyres te shoqerise "Albpetrol" sh.a.**
**Tirane**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te shoqerise "Albpetrol" sh.a qe perfshijne :

- bilancin kontabel me 31 Dhjetor 2010
- pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve
- pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin e vet
- pasqyren e flukseve te parave per vitin ushtrimor

si dhe nje permbledhje te politikave kontabel kryesore dhe shenime te tjera shpjeguese.

***Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare***

Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave te duhura kontabel dhe kryerjen e vleresimeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

***Pergjegjesia e Audituesit***

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tone. Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarde kerkojne qe ne te respektojme kerkesat e etikes, te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te perftojme siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale.

Auditimi perfshin procedura per te marre prova auditimi per vlerat dhe informacionet e paraqitura ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire dhe vleresimin e riskut te ekzistences se anomalive materiale ne pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Ne berjen e ketyre vleresimeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare, por jo me qellim qe te shprehe nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin per pershtatshmerine e parimeve kontabel te perdorura; arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga Drejtimi i shoqerise dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per dhenien e opinionit tone te auditimit.

Arsyet per dhenien e opinionit te auditimit me rezerve :

1. Pas rivleresimit te Aktiveve Afatgjata Materiale (kryer me 31 dhjetor 2005) nga shoqeria jane bere korrigjime te tjera ne tepricat e tyre te çeljes, per pasoje, shoqeria nuk ishte ne gjendje te kryente nje rakordim te vlerave te AAM-ve te regjistruara ne librat kontabel me tabelat e rivleresimit, me 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009.

Po keshtu, gjate vitit ushtrimor shoqeria nuk ka bere test zhvleresimi per te percaktuar nese AAM-te kane renie ne vlere me 31 Dhjetor 2010.

Shoqeria e ka llogaritur shumen e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale bazuar në vleren kontabel te rivleresuar te aktiveve afatgjata materiale, sipas normave për grupe aktivesh të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës, të cilat nuk janë bazuar në jetën e dobishme të aktiveve.

Ne aktivet e shoqerise jane paraqitur aktivet jo ne shfrytezim te rezultuara nga bashkimi administrativ i shoqerive Albpetrol sh.a, Servcom sh.a dhe Transnafta sh.p.k. ne shumen 99.009.456 leke, te cilat sipas V.K.M. Nr.784, date 15.09.2006 "Per ristrukturimin e shoqerive tregtare me kapital shteteror Albpetrol sh.a, Servcom sh.a. dhe Transnafta sh.p.k", nuk duhej te perfshiheshin ne aktivet e shoqerise.
Ne aktivet e shoqerise jane paraqitur vlera e banesave te punonjesve ne shumen 211.518.753 leke.
Sipas V.K.M. Nr.470, date 31.08.2000, keto aktive i kalojne per administrim Entit Kombetar te Banesave por gjate vitit 2010 veprimet per kete transaksion jane kryer vetem per banesa ne vleren 55.231.450 leke.
Pra aktivet afatgjata materiale jane pasqyruar me teper per vleren 99.009.456 leke, aktivet te tjera afategjata jane pasqyruar me teper per vleren 211.518.753 leke dhe huamarrje te tjera afategjata (k/Parti) pasqyruar teper shuma 310.528.209 leke

Per shkak te natyres se rregjistrimeve kontabel dhe mangesive te pershkruara me siper, ne nuk ishim ne gjendje te percaktojme se cfare veprimi rregullues mund te ishte i nevojshem per tu kryer ne pasqyrat financiare te Albpetrol Sh.a.

2. Ne bilancin kontabel te shoqerise eshte paraqitur zhvleresimi i kerkesave te arketueshme ne shumen 228.831.368 leke, per te cilat shoqeria nuk ka percaktuar metodat qe duhej te perdoreshin ne llogaritjen e zhvleresimit te kerkesave te arketueshme dhe nuk ka kryer detajimin e sakte te tyre.

Gjithashtu shoqeria nuk ka llogaritur zhvleresimin e kerkesave te arketueshme per faturat e papranuara nga klientet.

Ne kushtet e mesiperme nuk mund te perllogaritet efekti i rregullimeve te nevojshme per t'u kryer ne lidhje me saktesimin e shumes se zhvleresimit te kerkesave te arketueshme per periudhen qe mbyllet me 31 Dhjetor 2010.

3. Shoqeria nuk ka krijuar provizione per detyrimet qe rrjedhin nga demtimi i ambientit gjate zhvillimit te aktivitetit te saj.

Ne kushtet e mesiperme nuk mund te perllogaritet efekti i rregullimeve te nevojshme per t'u kryer ne lidhje me shumen e provizionit qe duhej krijuar per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga demtimi i ambientit per periudhen qe mbyllet me 31 Dhjetor 2010.

4. Shoqeria nuk ka kryer testin e zhvleresimit te inventarit i cili eshte gjendje ne magazine per nje periudhe te gjate kohe.

Ne kushtet e mesiperme nuk mund te perllogaritet efekti i rregullimeve te nevojshme per t'u kryer ne lidhje me shumen e testit te zhvleresimit te inventarit ne daten e mbylljes se bilancit.

*Opinioni*

Sipas opinionit tone, me perjashtim te efekteve ne pasqyrat financiare te çeshtjeve te trajtuara ne pikat e mesiperme (1-4), pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te drejte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te shoqerise Albpetrol sh.a. me 31 Dhjetor 2010, rezultatin e saj financiar dhe flukset e parave per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Ekspertet Kontabel te Regjistruar

Njazi Laze

Nexhmije Çela

Neshat Mazaj

Paqsor Qato

Mimoza Çibuku

Lavdimir Fusha

Luan Gosnishti

Diana Golemi

Vjollca Dervishi

Teit Gjini

Leonidha Foti

LIRENG Auditing Sh.p.k. TIRANË - ALBANIA

EURO - AUDIT CONSULTANCY.CO Sh.p.k. TIRANE - ALBANIA

E. K. A. LAVDIMIR FUSHA TIRANE ALBANIA

I.E.K.A. EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR Luan GOSNISHTI

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR K31424141F TIRANE

Tirane, me 30 Qershor 2011

ALBPETROL SHA PATOS 2010

| | Zeri i Bilancit | shenim | Viti ushtrimor 2010 | Viti paraardhes 2009 |
|---|---|---|---|---|
| A | AKTIVET | | | |
| I | **Aktivet Afatshkurtera** | | 17,770,078,363 | 15,306,681,324 |
| 1 | **Mjetet monetare** | 4 | 49,316,659 | 34,418,795 |
| 2 | **Derivative dhe Aktive Financiare te mbajtura per tregti** | | 0 | 0 |
| a) | Derivativet | | | |
| b) | Aktivet e mbajtura per tregtim | | | |
| | Totali | | 0 | 0 |
| 3 | **Aktive te tjera financiare afatshkurtera** | | 13,769,533,899 | 13,133,494,107 |
| a) | Llogari / Kerkesa te arketueshme | 5 | 12,848,568,535 | 12,143,700,019 |
| b) | Llogari / Kerkesa te tjera te arketueshme | 6 | 1,149,796,732 | 1,217,458,311 |
| c) | Instrumente te tjera borxhi | | 0 | 0 |
| d) | Investime te tjera financiare(shpenz brendshme186) | | 0 | 0 |
| e) | Zhvleresimi I kerkesave te arketueshme | 7 | -228,831,368 | -227,664,223 |
| | Totali | | 13,769,533,899 | 13,133,494,107 |
| 4 | **Inventari** | 8 | 3,951,227,805 | 2,138,768,422 |
| a) | Lendet e para | | 612,139,697 | 481,411,550 |
| b) | Prodhim ne proces | | 32,473,908 | 1,321,699 |
| c) | Produkte te gatshme | | 2,299,752,184 | 999,654,424 |
| d) | Mallra per rishitje | | 1,023,922,442 | 673,441,175 |
| e) | Parapagesat per furnizime | | 0 | 0 |
| f) | Zhvleresimi I inventareve | | -17,060,426 | -17,060,426 |
| | Totali | | 3,951,227,805 | 2,138,768,422 |
| 5 | **Aktivet biologjike afatshkurtera** | | 0 | 0 |
| 6 | **Aktivet afatshkurtera te mbajtura per shitje** | | 0 | 0 |
| 7 | **Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra** | | 0 | 0 |
| | **Mardh te brendshme** | | 0 | 0 |
| | TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTERA | | 17,770,078,363 | 15,306,681,324 |
| II | **Aktivet Afatgjata** | | 51,692,690,558 | 51,899,953,060 |
| 1 | **Investimet financiare afatgjata** | | 0 | 0 |
| a) | Aksione dhe pjesemarrje te tjera ne njesi te kontrolluara | | 0 | 0 |
| b) | Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje | | 0 | 0 |
| c) | Aksione dhe letra te tjera me vlere | | 0 | 0 |
| d) | Llogari / Kerkesa te arketueshme afatgjata | | 0 | 0 |
| | Totali | | 0 | 0 |
| 2 | **Aktive afatgjata materiale** | 9 | 50,651,097,843 | 50,675,169,199 |
| a) | Toka | | 14,926,766,935 | 14,305,627,025 |
| b) | Ndertesa | | 1,800,056,539 | 1,534,239,224 |
| c) | Makineri e pajisje | | 33,855,954,556 | 34,765,097,222 |
| d) | Aktive te tjera afatgjata materiale | | 68,319,813 | 70,205,728 |
| | Totali | | 50,651,097,843 | 50,675,169,199 |
| 3 | **Aktivet biologjike afatgjata** | | 120,833 | 0 |
| 4 | **Aktivet afatgjata jomateriale** | | 0 | 7,991,197 |
| a) | Emri i mire | | 0 | 0 |
| b) | Shpenzimet e zhvillimit | 10 | | 7,991,197 |
| c) | Aktive te tjera afatgjata jomateriale | | | |
| | Totali | | 0 | 7,991,197 |
| 5 | **Kapital aksionar i papaguar** | | 0 | 0 |
| 6 | **Aktive te tjera afatgjata (ne proces)** | 11 | 829,953,129 | 950,042,461 |
| | **Aktive te tjera afatgjata (banesa)** | | 211,518,753 | 266,750,203 |
| | TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA | | 51,692,690,558 | 51,899,953,060 |
| | TOTALI AKTIVEVE | | 69,462,768,921 | 67,206,634,384 |

| | Zeri i Bilancit | shenime | Viti ushtrimor 2010 | Viti paraardhes 2009 |
|---|---|---|---|---|
| B | PASIVET | | | |
| I | **Pasivet Afatshkurtera** | | 9,580,578,087 | 9,337,137,847 |
| 1 | **Derivativet** | | | |
| 2 | **Huamarrjet** | | 0 | 150,000,000 |
| a) | Huate dhe obligacionet afatshkurtera | 12 | 0 | 150,000,000 |
| b) | Kthimet / Ripagesat e huave afatgjata | | | |
| c) | Bono te konvertueshme | | | |
| | Totali | | 0 | 150,000,000 |
| 3 | **Huate dhe parapagimet** | | 9,447,742,783 | 9,045,707,221 |
| a) | Te pagueshme ndaj furnitoreve | 13 | 8,985,319,877 | 8,250,109,705 |
| b) | Te pagueshme ndaj punonjesve | 14 | 217,440,159 | 166,006,347 |
| c) | Detyrime tatimore | 15 | 33,555,937 | 481,403,057 |
| d) | Hua te tjera | 16 | 211,426,810 | 148,188,112 |
| e) | Parapagimet e arketuara(mardh me Albpetrolin DF) | | 0 | 0 |
| | Mardhenie me njesite | | 0 | 0 |
| | te ardhura te brendshme(187) | | 0 | 0 |
| | Totali | | 9,447,742,783 | 9,045,707,221 |
| 4 | **Grandet dhe te ardhurat e shtyra** | 17 | 102,835,304 | 126,430,626 |
| 5 | **Provizionet afatshkurtera** | 18 | 30,000,000 | 15,000,000 |
| | PASIVE TOTALE AFATSHKURTERA | | 9,580,578,087 | 9,337,137,847 |
| II | **Pasivet Afatgjata** | | 605,982,981 | 519,424,716 |
| 1 | **Huate afatgjata** | 19 | 154,365,368 | 153,665,057 |
| a) | Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare | | 154,365,368 | 153,665,057 |
| b) | Bonot e konvertueshme | | 0 | 0 |
| | Totali | | 154,365,368 | 153,665,057 |
| 2 | **Huamarrje te tjera afatgjata** | | 0 | 0 |
| | **K/parti(banesa)** | 20 | 211,518,753 | 266,750,203 |
| | **K/parti(AAM per j.perdorimit)** | | 240,098,860 | 99,009,456 |
| 3 | **Provizionet afatgjata** | | 0 | 0 |
| 4 | **Grandet dhe te ardhurat e shtyra** | | 0 | 0 |
| | PASIVE TOTALE AFATGJATA | | 605,982,981 | 519,424,716 |
| III | **Kapitali** | | 59,276,207,853 | 57,350,071,821 |
| 1 | **Aksionet e pakices** | | 0 | 0 |
| 2 | **Kapitali i aksionereve te shoqerise meme** | | 0 | 0 |
| 3 | **Kapitali aksionar** | 21 | 10,388,375,000 | 10,406,529,000 |
| | **Kapitali nga ish Uzinat Mekanike** | 22 | 872,807,896 | 0 |
| 4 | **Primi i aksionit** | 23 | 14,046,688,275 | 14,046,688,275 |
| 5 | **Njesite ose aksionet e thesarit** | | 0 | 0 |
| 6 | **Rezerva statusore** | | 0 | 0 |
| 7 | **Rezerva ligjore** | 24 | 122,697,313 | 102,404,968 |
| 8 | **Rezerva te tjera** | 25 | 2,007,116,458 | 1,662,146,599 |
| 9 | **Rezerva rivleresimi** | | 30,727,952,715 | 30,726,456,086 |
| 10 | **Fitimet e pashperndara** | | 0 | 0 |
| 11 | **Fitimi (Humbja) i vitit financiar** | 26 | 1,110,570,196 | 405,846,893 |
| | TOTALI I KAPITALIT | | 59,276,207,853 | 57,350,071,821 |
| | TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT | | 69,462,768,921 | 67,206,634,384 |

**Drejtore Drejtorise se Finances** **Drejtori Pergjithshem**

Enkelejda PESHKEPIA Ferdinand MURATI

**Albpetrol sha**

**Te ardhura shpenzime 2010**

| PERSHKRIMI | Viti ushtrimor | Viti paraardhes |
|---|---|---|
| Shitjet neto | 5,698,088,296 | 6,025,484,866 |
| Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | 354,816,953 | 1,026,453,182 |
| Ndryshimet ne inventarin e produktit te gatshem e ne proces | 1,160,085,268 | -86,381,207 |
| Puna e kryer nga njesia per qellimet e veta dhe e kapitalizuar | 5,538,246 | 12,575,203 |
| Lendet e para, mallrat dhe sherbimet | -886,146,836 | -933,088,152 |
| Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | -1,425,732,575 | -2,118,995,550 |
| Shpenzime te personelit | -3,030,543,632 | -2,963,359,829 |
| Pagat | -2,670,974,863 | -2,629,520,573 |
| Shpenzimet e sigurimeve shoqerore | -332,160,619 | -333,839,256 |
| Shpenzimet per pensionet | -27,408,150 | 0 |
| Renia ne vlere (zhvleresimi) dhe amortizimi | -532,006,366 | -510,481,023 |
| **Fitimi (Humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit** | 1,344,099,354 | 452,207,490 |
| Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrollu | 0 | 0 |
| Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet | 0 | 0 |
| Te ardhurat dhe shpenzimet financiare | -63,372,616 | 101,998,724 |
| Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime afatgjat | 0 | 0 |
| Te ardhurat dhe shpenzime nga interesi | -3,735,891 | -8,386,452 |
| Fitimet (Humbjet) nga kursi i kembimit | -59,636,725 | 110,385,176 |
| Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare afatshkurtera | 0 | 0 |
| Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare | -63,372,616 | 101,998,724 |
| Sistemime te shpenz.viti 2006-2009 QSHET | 0 | 0 |
| **Fitimi (Humbja) para tatimit** | 1,280,726,738 | 554,206,214 |
| | 0 | 0 |
| Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | -170,156,542 | -148,359,321 |
| | 0 | 0 |
| **Fitimi (Humbja) neto e vitit financiar** | 1,110,570,196 | 405,846,893 |
| Pjesa e fitimit neto per aksionaret e shoqerise meme | 0 | 0 |
| Pjesa e fitimit neto per aksionaret e pakices | 0 | 0 |

**Drejtore Drejtorise se Fianaces**
**Enkelejda Peshkepia**

**Drejtori Pergjithshem**
**Ferdinand Murati**

MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
ALBPETROL SHA
DREJTORIA
-PATOS-

**ALBPETROL SHA PATOS**

## Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per ushtrimin kontabel 2010

| Emertimi | Kapitali aksionar | Primi i aksionit | Aksione te thesarit | Rezerva ligjore e statusore | Rezerva te tjera | Fitimi i pa-shperndare | Kapitali UM Patos UM Kucove | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2008** | 10,193,877 | 8,160,950 | 0 | 61,497 | 31,693,173 | 818,143 | 220,649 | 51,148,289 |
| Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabel | | | | | | | | 0 |
| **Pozicioni i rregulluar** | 10,193,877 | 8,160,950 | 0 | 61,497 | 31,693,173 | 818,143 | 220,649 | 51,148,289 |
| Fitimi neto per periudhen kontabel | | | | | | 405,847 | | 405,847 |
| Dividendet e paguar | | | | | | -81,814 | | -81,814 |
| Rritja e rezerves se kapitalit | | | | 40,908 | 695,421 | -736,329 | | 0 |
| Primi I aksionit | | 5,885,738 | | | | | | 5,885,738 |
| Emetimi i aksioneve | 212,652 | | | | | | | 212,652 |
| Kapitali ish Servcom + Transnafta | | | | | | | -220,649 | -220,649 |
| Sistemime nga rivleresimi i AAM-ve | | | | | 9 | | | 9 |
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2009** | 10,406,529 | 14,046,688 | 0 | 102,405 | 32,388,603 | 405,847 | | 57,350,072 |
| Fitimi neto per periudhen kontabel | | | | | | 1,110,570 | | 1,110,570 |
| Dividendet per t'u shperndare | | | | | | -40,585 | | -40,585 |
| Rritja e rezerves se kapitalit | | | | 20,292 | 344,970 | -365,262 | | 0 |
| Primi I aksionit | | 0 | | | | | | 0 |
| Emetimi i aksioneve | -18,154 | | | | | | | -18,154 |
| Sistemime nga rivleresimi i AAM-ve | | | | | 1,497 | | | 1,497 |
| Kapitali UM Patos&UM Kucove | 0 | | | | | | 872,808 | 872,808 |
| **Pozicioni me 31 Dhjetor 2010** | 10,388,375 | 14,046,688 | 0 | 122,697 | 32,735,070 | 1,110,570 | 872,808 | 59,276,208 |

**Drejtore Drejtorise se Finances**

**Enkelejda PESHKEPIA**

**Drejtori Pergjithshem**

**Ferdinand MURATI**

MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
ALBPETROL SHA
DREJTONIA
-PATOS-

Shoqeria Albpetrol sha, Patos

Pasqyra e Fluksit te parase per ushtrimin kontabel 2010

| | Fluksi i parase - Metoda indirekte | Viti ushtrimor | Viti paraardhes |
|---|---|---|---|
| **A** | **Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytezimit** | 443,520,856 | 17,281,966 |
| **1** | Fitimi para tatimit (+) | 1,280,726,738 | 554,206,214 |
| **2** | Rregullime : | 868,694,397 | 421,611,855 |
| | a) Amortizimi (+) | 532,006,366 | 510,481,023 |
| | b) Sistemime per amortizimin (shih: Shpenzime te tjera) (+) | 107,611,310 | |
| | c) Kerkese (+) / Detyrim (-) per tatimin mbi fitimin e ushtrimit | 42,986,854 | -88,869,168 |
| | d) Te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata (-) | | |
| | e) Humbje nga dalja e aktiveve afatgjata (+) | 186,089,867 | |
| | f) Fitime (-) / Humbje (+) te llogaritura per kembimet valutore | | |
| | g) Shpenzime te llogaritura per interesa (+) | | |
| | h) Shpenzime te llogaritura per provizione (+) | | |
| | i) Fitime te pashperndara te pjesemarrjeve (-) | | |
| | | | |
| **3** | Rritje (-) / renie (+) ne tepricen e kerkesave te arketueshme dhe kerkesave te tjera te arketueshme | -636,039,792 | -2,718,861,782 |
| **4** | Rritje (-) / renie (+) ne tepricen e inventarit | -1,812,459,383 | 67,917,679 |
| **5** | Rritje (+) / renie (-) ne tepricen e detyrimeve per t'u paguar | 252,735,873 | 1,750,766,316 |
| **6** | Rritje e detyrimeve nga Kapitali per t'u zmadhuar (UM Kuçove dhe UM Patos) minus mjetet monetare (+) | 726,601,744 | |
| **7** | Rritje (+) / renie (-) ne tepricen e granteve | -23,595,322 | 1,131,837 |
| **8** | Tatim mbi fitimin i parapaguar per ushtrimin (-) | -213,143,399 | -59,490,153 |
| | Totali i parase neto nga veprimtarite e shfrytezimit | 443,520,856 | 17,281,966 |
| | | | |
| **B** | **Fluksi i parave nga veprimtarite investuese** | -428,622,992 | -267,554,070 |
| **1** | Blerja e kompanise se kontrolluar X minus parate e arketuara (-) | | |
| **2** | Blerja e aktiveve afatgjata materiale (-) | -428,622,992 | -267,554,070 |
| **3** | Te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata (+) | | |
| **4** | Interesi i arketuar (+) | | |
| **5** | Dividendet e arketuar (+) | | |
| | Totali i parase neto nga veprimtarite investuese | -428,622,992 | -267,554,070 |
| | | | |
| **C** | **Fluksi i parave nga veprimtarite financiare** | 0 | 0 |
| **1** | Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar (+) | | |
| **2** | Te ardhura nga huamarrje afatgjata (+) | | |
| **3** | Pagesat e detyrimeve te qerase financiare (-) | | |
| **4** | Dividendet e paguar (-) | | |
| | Totali i parase neto nga veprimtarite financiare | 0 | 0 |
| | | | |
| | **Rritja / renia neto e mjeteve monetare** | 14,897,864 | -250,272,104 |
| | **Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel** | 34,418,795 | 284,690,899 |
| | **Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel** | 49,316,659 | 34,418,795 |

**Drejtore Drejtorise se Finances**

**Enkelejda PESHKEPIA**

**Drejtori Pergjithshem**

**Ferdinand MURATI**

MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJISE
ALBPETROL SHA
DREJTORIA
-PATOS-

## Shenimi 1 – Te Pergjithshme

Shoqëria "ALBPETROL"Sh.A., është krijuar juridikisht, sipas vendimit të gjykatës së rrethit Gjyqesor Tiranë Nr.21158 , date 08.04.1999. Selia e shoqerise eshte ne adresen Patos, Fier.

Kapitali i nenshkruar i saj eshte 10.388.375.000 leke, i ndare ne 10.388.375 aksione me vlere nominale 1.000 leke seicili. Aksionet zoterohen ne masen 100% nga Shteti Shqiptar, me perfaqesues Ministrine e Ekonomise,Tregetise dhe Energjitikes.

Objekti i veprimtarise:

Shoqeria "Albpetrol" sha, Patos ka per objekt operacionet e kerkimit, te zhvillimit dhe prodhimit te hidrokarbureve si dhe çdo veprimtari tjeter te mundshme dhe te ligjshme ne perputhje me interesat e saj, siç percaktohen ne Statutin e Shoqerise dhe ne Vendimin e Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Keshilli Mbikqyres i emeruar nga Ministri i Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes. Keshilli mbikqyres perbehet :

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1- Z. | Gjergji | KOSTA | Kryetar |
| 2- Znj. | Suzana | GUXHOLLI | Anetar |
| 3- Z. | Kostaq | MILO | Anetar |
| 4- Z . | Alfred | PRIFTI | Anetar |
| 5- Z. | Elvi | FUNDO | Anetar |
| 6- Z. | Bujar | HASA | Anetar |

Veprimtaria e perditeshme e shoqerise drejtohet nga Drejtoria. Ajo perbehet nga dy anetare nga te cilet njeri emerohet Drejtor i Pergjithshem. Drejtorit te Pergjithshem i perkasin te gjitha kompetencat per drejtimin ekzekutiv dhe perfaqeson shoqerine ne marrdheniet me te tretet.

Drejtoria perbehet nga :

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1- Z. Ferdinand | MURATI | Drejtor i | Pergjithshem |
| 2- Z. Pajtim | SULAJ | Zv/Drejtor i | Pergjithshem |

Gjate periudhes 01.01.2010 deri me 31.12.2010 shoqeria ka kryer aktivitetin e saj ne perputhje me objektin e krijimit te saj.
Bazuar ne strategjine e zhvillimit te shoqerise, ku prioritet i vecante i eshte dhene thithjes se investimeve te huaja, gjate vitit 2010 eshte rritur ndjeshem bashkepunimi i shume kompanive te huaja me eksperience ne zhvillimin e vendburimeve te naftes dhe te gazit per kerkim-zbulimin e zhvillimin e vendburimeve qe administron Albpetroli.
Ne zbatim te Marreveshjeve Hidrokarbure me kompanite Bankers Petroleum Albania Ltd, Stream Oil&Gaz Ltd, Sherwood dhe IEC Visoke, nga momenti i fillimit te marreveshjeve dhe deri me 31.12.2010 jane dorezuar gjithesej 1145 puse si me poshte:

| Nr | Emertimi Kompanise | Nr puseve te dorezuar |
|---|---|---|
| 1 | **Bankers Petroleum Albania Ltd** | **748** |
| 2 | **Stream Oil&Gaz Ltd** | **374** |
| 3 | **Sherwood** | **12** |
| 4 | **IEC Visoke** | **11** |
| | **Gjithesej puse te dorezuar** | **1145** |

## Shenimi 2 – Bazat e pergatitjes

### 2.1 Deklarate e perputhjes me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat finaciare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

### 2.2 Bazat e vleresimit

Pasqyrat financiare u pergatiten ne baze te parimit te kostos historike.

### 2.3 Monedha funksionale dhe ajo raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyrat financiare jane vleresuar ne monedhen shqiptare Leke, e cila eshte edhe monedha funksionale e Shoqerise. Shoqeria raporton pasqyrat financiare ne Leke.

### 2.4 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve

Pergatitja e pasqyrave finaciare kerkon qe te behen gjykime, vleresime dhe perllogaritje te cilat kane efekte ne aplikimin e politikave kontabel dhe ne vlerat e aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve.Vleresimet dhe perllogaritjet jane bazuar ne pervojen e meparshme dhe ne faktore te tjere te cilet drejtimi i Shoqerise i konsideron te arsyeshem sipas rrethanave. Rezulatet e tyre perbejne bazen per vleresimin e vleres per t'u mbartur te aktiveve dhe detyrimeve per te cilat nuk jane dhene informacione shpjeguese ne burime te tjera. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga vleresimet qe ishin bere

Vleresimet dhe perllogaritjet themelore jane rishikuar ne vazhdimesi. Rishikimi i vleresimeve kontabel eshte njohur ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte ripare dhe ne çdo periudhe te ardhshme qe ndikohet.

## Shenimi 3 – Politikat e pergjitshme kontabel

Politikat kontabel qe jane prezantuar me poshte jane aplikuar ne menyre te qendrueshme per te gjitha periudhat e paraqitura ne pasqyrat finaciare.

### 3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj jane perkthyer ne monedhen funksionale te Shoqerise sipas kursit te kembimit ne daten e transaksionit. Diferencat e kembimit te lindura nga shlyerja ose raportimi i nje zeri monetar te njohur filimisht me nje kurs tjeter kembimi jane ngarkuar tek zeri specifik i pasqyres se te ardhurave dhe shpenzimeve (p.sh. te ardhurat, kosto e mallrave te shitur, kosto te finacimit etj.)
Diferencat e kembimit te lindura nga konvertimi i investimit neto te shoqerise meme jane njohur si nje ze i veçante ne kapitalin e Shoqerise.

## 3.2 Instrumentat Finaciare

### 3.2.1 Instrumentat financiare jo- derivative

Instrumentat financiare jo- derivative perfshijne investimet ne aksione, kerkesa te arketueshme nga klientet, te tjera kerkesa te arketueshme, mjete monetare dhe te ngjashme, kredi te dhena dhe te marra, llogari te pagueshme te te treteve.

Instrumentat financiare jo-derivative jane njohur fillimisht me vleren e drejte plus te gjitha kostot e transaksionit qe i perkasin ne menyre te drejtperdrejte.

Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare

Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare perfshijne gjendjet e llogarive dhe depozitat qe mund te terhiqen menjehere. Ekuivalente te mjeteve monetare perfshijne gjithashtu depozita afatshkurtra me pak se tre muaj.

Investimet te prezantuara me vleren e drejte nepermjet pasqyrese se te ardhurave

Nje instrument financiar eshte klasifikuar si i vleresuar me vleren e drejte nepermjet pasqyres se te ardhurave nese eshte i mbajtur per t'u shitur. Instrumentat financiare percaktohen si te vleresuar me vleren e drejte nepermjet pasqyres se te ardhurave nese Shoqeria i menaxhon keto investime dhe merr vendimet per blerjen dhe shitjen e tyre bazuar ne vleren e drejte. Pas njohjes fillestare, kostot e lidhura drejpersedrejti me transaksionin njihen si te ardhura dhe shpenzime kur ato ndodhin. Keto instrumenta financiare vleresohen me vleren e drejte dhe ndryshimet perkatese njihen si te ardhura ose shpenzime te periudhes ushtrimore.

Te tjera
Instrumentat e tjere financiare jo derivative vleresohen me kosto te amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv, minus humbjen nga rivleresimi, si me poshte:

Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjerat jane paraqitur me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvleresimi. Pasqyrat financiare perfshijne provizione speciale ne lidhje me llogarite e arketueshme te dyshimta, te cilat sipas opinionit te organeve drejtuese te Shoqerise, reflektojne ne menyre te mjaftueshme humbjen e perfshire ne ato llogari , mbledhja e te cilave eshte e dyshimte.
Percaktimi i mjaftueshmerise se provizionit nga ana e organeve drejtuese eshte bazuar, nder te tjera edhe ne vleresimin e rrezikshmerise, duke konsideruar informacionin ne dispozicion per bilancin e debitorit, volumin e aktivitetit te tyre tregtar dhe garancive te marra prej tyre.

Llogarite e arketueshme afatgjata jane deklaruar me vleren e tyre aktuale.

## 3.3 Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale
Aktivet afatgjata materiale jane vleresuar me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rivleresimi. Aktivet afatgjata te prodhuara nga Shoqeria perfshijne kostot e materialeve te perdoruara dhe punen direkte.
Shpenzimet pasuese
Rinovimet dhe riparimet kapitale i jane shtuar kostos se aktivit ndersa kostot e mirembajtjes dhe riparimeve te vogla jane njohur si shpenzime kur ato kane ndodhur.

**Amortizimi**

Amortizimi eshte njohur si shpenzim ne menyre lineare mbi bazen e jetes se dobishme te grupeve te aktiveve afatgjata dhe normat e amortizimit jane si me poshte:

| | |
|---|---|
| Ndertesa | 1.5 % |
| Lidhje teknologjike,puse tubacione | 1.5% |

Amortizimi eshte njohur si shpenzim i llogaritur sipas menyres mbi vleren e mbetur te grupeve te aktiveve afatgjata dhe normat e amortizimit jane si me poshte:

| | |
|---|---|
| Makineri dhe pajisje | 2.5 % |
| Pajisje etj | 3 % |

Metoda e amortizimit rishikohen cdo periudhe ushtrimore.

### 3.4 Aktivet Afatgjata Jomateriale

#### 3.4.1 Emri i mire

Emri i mire njihet ne blerjen e filialeve, *joint ventures* dhe aktiviteteve.

Emri i mire perfaqeson tepricen midis kostos se blerjes me interesin e Shoqerise ne vleren e drejte te aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve te mundshme te shitesit. Ne rast se teprica eshte negative (emri i mire negativ) eshte njohur menjehere ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Matja pas njohjes fillestare

Emri i mire matet me kosto minus humbjet nga zhvleresimi.

#### 3.4.2 Te tjera Aktive Afatgjata Jomateriale

Te tjera aktive afatgjata jo-materiale perfshijne,marka, marredhenie me kliente, rrjet shperndarjeje dhe marreveshje per moskonkurrence kur keto jane blere.

#### 3.4.3 Amortizimi

Aktivet Afatgjata Jomateriale te cilat kane nje jete dobishme te fundme jane vleresuar si diference e vleres historike me amortizimin e akumumuluar dhe humbjeve nga zhvleresimi. Amortizimi eshte njohur si shpenzim ne menyre lineare ne baze te jetes se dobishme te aktivit nga data qe aktivi ka qene ne dispozicion te Shoqerise.

Normat vjetore te amortizimit jane si me poshte (metoda lineare)

| | Ne% |
|---|---|
| Te tjera aktive | 10 % |

Emri i mire dhe aktivet me jete te pafundme nuk amortizohen.

### 3.5 Inventari

Inventari eshte paraqitur me vleren me te ulet mes kostos dhe vleres se realizueshme neto.Kosto eshte llogaritur si vijon:

| | |
|---|---|
| Lendet e para | – Me koston e blerjes dhe inventari i imet kosto blerje minus konsumin e llogaritur. |
| Prodhime ne process | – Me kosto ne baze te metodes se mesatares se ponderuar |
| Produkt i gatshem | – Me kosto ne baze te metodes se mesatares se ponderuar |

### 3.6 Zhvleresimi (Renia ne vlere)

#### 3.6.1 Aktivet jofinanciare

Vlera e mbartur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, pervec inventarit dhe tatimit te shtyre, rishikohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka gjasa per zhvleresim. Ne rast se evidentohet mundesia per zhvleresim, atehere ripercaktohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Per aktivet e patrupezuara qe nuk jane te gatshme per perdorim, vlera e rikuperueshme perllogaritet ne çdo date te bilancit.

Nje zhvleresim njihet atehere kur vlera kontabel e nje aktivi apo vlera e flukseve qe do te gjeneroje, eshte me e madhe se vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e flukseve qe gjenerohen eshte grupi me i vogel i identifikueshem i aktiveve qe gjeneron flukse te parase qe jane kryesisht te pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvleresimet njihen ne pasqyren e fitimeve dhe humbjeve. Per te vleresuar vleren ne perdorim, flukset e ardhshme te parashikuara te parase aktualizohen nga vlera e tyre ekzistuese duke perdorur nje norme aktualizimi pa llogaritur tatimet, e cila reflekton vleresimet aktuale te tregut te vleres monetare ne kohe dhe rreziqet specifike qe kane lidhje me ate aktiv.

Per sa i perket aktiveve te tjera, humbja nga zhvleresimi kthehet nese ka shenja qe kjo humbje nuk ekziston me dhe ka pasur nje ndryshim ne perllogaritjet e perdorura per te percaktuar shumen e rikuperueshme. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet vetem deri ne shkallen qe gjendja e mbartur e aktivit nuk eshte me madhe se gjendja e mbartur qe do te ishte percaktuar, neto e zhvleresimit dhe amortizimit, ne rast se nuk ka qene njohur asnje humbje nga zhvleresimi.

#### 3.6.2 Aktivet Financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvleresuar ne ato raste kur ekzistojne evidenca objektive qe tregojne se nje apo me shume ngjarje kane patur efekt negativ ne flukset e ardhshme te parase se atij aktivi.

Humbja nga zhvleresimi lidhur me nje aktiv financiar te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diferenca midis vleres kontabel te aktivit dhe vleres ekzistuese te flukseve te ardhshme te parase, e aktualizuar me normen origjinale efektive te interesit te aktivit.

Llogarite e arketueshme me nje kohezgjatje te shkurter nuk aktualizohen. Aktivet e rendesishme financiare testohen ne menyre te veçante per zhvleresime te mundshme. Aktivet e mbetura financiare vleresohen mbi baze grupesh qe kane karakteristika te ngjashme te riskut te kredise. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave. Nje humbje nga zhvleresimi kthehet mbrapsht nese kthimi mund te lidhet objektivisht me ngjarje qe ndodhin pasi ky zhvleresim eshte njohur.

### 3.7 Shpenzime per personelin

#### 3.7.1 *Kontributet per sigurimet shoqerore dhe te ngjashme*

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve te saj per te kontribuar per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te derdhura ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave ne momentin qe ato ndodhin.

#### 3.7.2 *Opsioni i pageses me aksione*

Vlera e drejte ne daten e dhurimit te opsioneve punonjesve njihet si nje shpenzim per punonjesit, qe i korrespondon nje rritje ne kapitalin neto, mbi periudhen ne te cilen punonjesit i lind e drejta e pakushtezuar per keto opsione aksionesh. Shuma e njohur si shpenzim rregullohet ne menyre qe te reflektoje numrin real te opsioneve te aksioneve qe dhurohen.

#### 3.7.3 Leja e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si detyrim shumen e paskontuar te kostove te parashikuara ne lidhje me lejen e zakonshme qe pritet t'ju paguhet punonjesve ne kembim te sherbimit te tyre per periudhen e mbyllur.

### 3.8 Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqeria ka nje detyrim aktual (ligjor ose te terthorte) si rezultat i nje ngjarje ne te kaluaren dhe ka mundesi qe do te nevojitet nje fluks burimesh qe perfshin perfitimet ekonomike per te permbushur detyrimin dhe ne kete menyre mund te behet nje perllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit. Ne rast se efekti eshte material, provizionet jane percaktuar duke skontuar flukset e pritshme te parase me normen e uljes para tatimeve, e cila reflekton vleren kohore te parase ne kushtet aktuale te tregut dhe, aty ku eshte e pershtatshme, normen e riskut te pasiveve specifike. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nese nuk ka me mundesi per nevojitjen e nje fluksi burimesh qe perfshin perfitimet ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet perdoren vetem per qellimin qe jane njohur fillimisht. Ato nuk njihen per humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtezuara nuk njihen.

### 3.9 Te ardhurat

#### 3.9.1 Produktet e shitura

Te ardhurat nga shitja e mallrave jane matur me vleren e drejte te pagesave te arketuara ose te arketueshme , pakesuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet.Te ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejte te kompesimit te marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatet. E ardhura eshte njohur kur rreziqet dhe te drejtat mbi produktet i kalojne ne nje pjese te rendesishme bleresit, marrja e kompesimit eshte e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te maten me besueshmeri dhe nuk ka me perfshirje te vazhdueshme te drejtimit te Shoqerise me keto produkte

Shoqeria deri ne muajin maj 2010, ka shitur naften bruto ne shoqerine Armo sh.a. sasine 49,908 ton nafte.
Nisur nga problematika e shitjeve me kete shoqeri, qeveria shqiptare nxorri Aktin Normativ Nr 2 date 16.06.2010 te Keshillit te Ministrave "Per nje shtese ne Ligjin Nr 7746 date 28.07.1993 "Per Hiodrokarburet (Kerkimi dhe Prodhimi)" i ndryshuar, me ane te te cilit shoqeria lejohet te tregetoje me procedure ankandi te miratuar nga Ministri i METE.
